Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës ose ftesën për tender].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 6

## LISTA E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

(Shënoni më poshtë informacionin që dëshironi të mbahet konfidencial)

--	--	--	--



Lloji, natyra e informacionit që duhet të mbetet konfidencial	Numri i faqes dhe pikat e DT që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet pse ky informacion duhet të mbetet konfidencial	Afati kohor që ky informacion të mbetet konfidencial

**KUJDES**

Çdo e dhënë, që nuk është regjistruar si e dhënë konfidenciale, do të konsiderohet se titullari i këtyre të drejtave ka dhënë vetë pëlqimin për dhënien e informacionit përkatës dhe Autoriteti Përgjegjës nuk mban asnjë përgjegjësi për publikimin e këtij informacioni.

Nuk përbën sekret tregtar informacioni, që duhet të bëhet publik në bazë të ligjit, që lidhet me shkeljen e ligjit, apo që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare e parimeve të etikës tregtare. Përhapja e këtij informacioni vlerësohet e ligjshme, nëse nëpërmjet këtij akti synohet të mbrohet interesi publik.

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 7

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik ]

**DEKLARATË****Mbi konfliktin e interesave**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Përgjegjës \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Konflikt i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohe në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në Kreun III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

---

Vula

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATE MBI PERMBUSHJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKEDHE REALIZIMIN E  
OBJEKTIT SIPAS GRAFIKUT TË PUNIMEVE

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilësinë \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj se:

Përbushim të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me certifikata e dokumenta (nëse kërkohen nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë, si dhe marrim përsipër realizimin e objektit sipas grafikut të punimeve të përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 9

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës në Marrëveshjen Kuadër]

PLANIFIKIMI I  
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR

<input type="checkbox"/> Punë: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____

Shtojca 10

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik ]

DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Përgjegjës \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilësinë \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në nenin 42 të Aktit normative nr.9/2019.
- Personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

\_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_ etj.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 42 të Aktit Normativ nr.9/2019<sup>2</sup>.

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Në çdo rast, autoriteti përgjegjës ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_

Vula \_\_\_\_\_

Shtojca 11

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik ]

## DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Përgjegjës \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

<sup>2</sup> Autorizoj Autoritetin përgjegjës të bëjë verifikimet përkatëse të gjendjes gjyqësore të personave të deklaruar në këtë Deklaratë

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 12

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik]

FORMULAR VLERËSIMI

( Ky formular do të shoqërohet me Akt kolaudimin dhe situacionet)

Autoriteti Përgjegjës /Investitori	
Adresa/Tel.	
Emri i Titullarit/Administratorit	
VËRTETOJ SE:	
Autoriteti Përgjegjës /Investitori ka nënshkruar kontratën me	
Emri i operatorit NIPT/ Bashkimit të operatorëve NIPTET/ Nënkontraktoret NIPTET	
Adresa/t	
Objekti i kontratës:	
Data e fillimit të kontratës	Data e mbarimit të kontratës
Vlera sipas kontratës	Vlera e realizuar
% e bashkimit të O.E. dhe përshkrimi i punëve të kryera nga secili anëtar Nënkontraktoret.	
Vlerësimi	(shprehur me fjalë)
	E përmbushur E papërmbushur
Firma	

Vula e Autoritetit Përgjegjës
-------------------------------

Shtojca 13

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik ]  
**MBI DISPONIMIN E MAKINERIVE**

Operatori ekonomik: \_\_\_\_\_

Deklaroj se zotëroj mjetet pajisjet teknike dhe asete të tjera fizike për të realizuar kontratën me objekt: \_\_\_\_\_

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
1				
2				
3				
4				
5				

Dhe

Me qera					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes së qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës së qerasë (Data e fillimit dhe mbarimit)
1					
2					
3					
4					
5					
6					

- shto/fshi rreshta të tjerë nëse nevojitet.

Ne autorizojmë autoritetin përgjegjës të verifikojë informacionin e dhëne në këtë tabelë.

**PERSONI I KONTAKTIT** (për këtë ofertë)

Emri:

Adresa:

Nr. Telefonit:

Faks:

E-mail:

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 14

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË MBI NDËRTIMET CIVILE DHE INDUSTRIALE<sup>3</sup>

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Përgjegjës \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Operatori ekonomik \_\_\_\_\_, nuk është subjekt i ndërtimeve civile (godina banimi ose ndërtesa të tjera shtetërore) dhe industriale të projektuara, ndërtuara, të mbikqyrura dhe/ose të kolaudura, të dëmtura nga ngjarja e fatkeqësisë natyrore, të përcaktuara në nenin 42/5/ë të Aktit normative nr.9/2019.

Personi/at në cilësinë e aksionarit, oraktu, administratorit dhe ose anëtarët e një organi administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësi i tij aksionar ose ortak duhet të deklarojnë se nuk kanë pasur kompetenca vendimarrëse në një shoqëri, ku ndërtimet civile (godina banimi ose ndërtesa të tjera shtetërore) dhe industriale të projektuara, të ndërtuara, të mbikqyrura dhe/ose të kolaudura, nga kjo e fundit janë të dëmtuara nga ngjarja e fatkeqësisë natyrore, të përcaktuara në nenin 42/5/ë të Aktit normative nr.9/2019.

Në çdo rast, autoriteti përgjegjës ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shënim: Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

<sup>3</sup> Akti normativ nr.9, date 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” neni 42, pika 5 shkronja ë).



Shtojca 15

[ Shtojce per tu plotesuar nga Autoriteti Përgjegjës]

## 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënua për shkelje penale, në përputhje me Nenin 42 të Aktit Normativ.
- ç) nuk është dënua me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet përgjegjëse.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rasti se kemi grupe operatorësh ekonomikë, seicili prej operatorëve duhet të dorëzojë vetdeklarimet, sipas kësaj Shtojce.

Në çdo rast, autoriteti përgjegjës ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim grup operatorësh ekonomikë, duhet te dorezohen:

a. Marrëveshja e noterizuar, sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht<sup>4</sup>;

b. Prokura e posaçme.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 4;*
- c. *Sigurim oferte sipas Shtojcës 5(Ne fazen e dyte );*
- ç. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*
- d. *Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 8;*

<sup>4</sup> Në këtë marrëveshje nuk duhet të përcaktohet përqindja e shërbimeve të seicilit anëtar, por fushat/ekspertizat e marra përsipër për tu realizuar.

dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojces 11;

e. Formular vlerësimi sipas Shtojcës 12;

f. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve/makinerive sipas Shtojcës 13;

g. Deklaratë mbi ndërtimet civile dhe industriale sipas aktit normative sipas Shtojcës 14;

gj. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri

2. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

(të plotësohet nga autoriteti përgjegjës)

2.1 Kapaciteti Ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

a) Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme, sipas shtojcës 10.

b) Operatori ekonomik ofertues nuk duhet të ketë detyrime të papaguara vendore, detyrime të ngarkuara nga organet kompetente audituese apo detyrime të ngarkuara nga organe të tjera në favor të Bashkisë Krujë dhe të Njësisë Administrative (ish Komuna dhe Bashki që i janë bashkuar Bashkisë Krujë), (deklarate të leshuar nga administratori/përfaqësuesi subjektit ofertues).

Shenim-Autoriteti kontraktor rezervon të drejten të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarinimin e mesiperm.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejten të verifikojë vertetesinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Për Prokurimin Publik".

C) Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të leshuar nga ana e njësive vendore ku operatori ekonomik ka selinë si dhe në vendet e tjera të ushtrimit të aktivitetit sipas QKB për vitin 2020, në rast se janë plotësuar afatet e maturimit të detyrimeve vendore për periudhën e mesipërme në përputhje me kërkesat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 " Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. (Edhe në rastet e bashkimit të operatoreve duhet të ketë vërtetimin e shlyerjes së taksës vendore për periudhat respektive për secilin operator)

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatori ekonomik për të provuar kapacitetet minimale financiare duhet të paraqesë si më poshtë vijon :

a) Operatori ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm gjatë tre viteve të fundit. Për këtë duhet të paraqesë kopje të vërtetuar të pasqyrave financiare për periudhën 2017, 2018 dhe 2019, të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse të konfirmuar nga ky autoritet me nënshkrim dhe vulë..

b) Kopje të deklarinimit të xhiros vjetore të 3(tri) viteve të fundit ushtrimore (2018,2019,2020) të leshuara dhe konfirmuara nga autoriteti përkatës kompetent, vlera mesatare e se ciles duhet të jete jo më e vogël se 50% e vlerës së fondit limit të prokuruar përkatësisht në shumën prej 110'105'449 (njqind e dhjete milion e njqind e pese mijë e katerqind e dyzet e nente ) leke pa t.v.sh..

Shenim:Pika 2.2-b)plotësohet duke dorëzuar edhe një vërtetim të leshuar nga Administrata Tatimore kompetente.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a)punëve të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të fondit limit të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit perkatesisht në shumën prej 88'084'359 (tetedhjetë e tete miliona tetedhjetë e kater mijë e treqind e pesedhjetë e nente ) leke pa t.v.sh...

b)punëve të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet perkatesisht në shumën prej 440'421'496(katerqind e dyzet milion e katerqindnjzet e njemijë e katerqind e nentedhjetë e gjashtë) leke pa t.v.sh.

Shenim- Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën oferten të kualifikueshme

c)Pika “2.3.1/a” plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Kurse pika “2.3.1/b “ duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

d)Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

Per punimet e kryera në sektorin publik duhet të paraqiten dokumentacioni provues si vijon:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 12, shoqëruar me:
- Kontratën/Kontratat;
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit;
- Faturat tatimore;

Dhe

Ndërsa në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontraten e Punimeve ose Lejen e Ndertimit;
- Situacionin përfundimtar ose situacionet pjesore ose situacion progresiv karabinaje;
- Akt kolaudim objekti ose akt kolaudimi karabinaje;
- Fatura tatimore;

2.3.1-e-Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontraten e bashkimit të operatoreve dhe prokurën e posaçme të deklaruara në fazën e tenderimit;

2.3.2. Liçensa profesionale të shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës e vlefshme sipas modelit të leshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastruktura/MIE.

Shoqëria ofertuese duhet të paraqesë licencën e shoqërisë të vlefshme për pikat dhe klasifikimin si më poshtë vijon:

*PUNIME TË PERGJITHSHME NDERTIMI*

- NP-1 A
- NP-2 D
- NP-3 A

- NP-12 A

*PUNIME SPECIALE NDERTIMI*

- NS-2 A
- NS-4 A
- NS- 6 A
- NS- 10 A
- NS- 14 A
- NS- 18A

Shenim-Licensa duhet te jete leshuar ne perputhje me kerkesat e VKM nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” te ndryshuar me VKM nr nr. 92 datë 19.02.2014.

*Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastruktues, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM Nr.42, date 16.01.2008 si dhe VKM 729, dt.12.11.2014 ndryshuar me VKM 943.DT 28.12.2016). Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.*

2.3.4-.Personeli dhe fuqia punetore:

Kandidati/ofertues duhet te vertetoje se disponon numrin e nevojshem te punonjesve per zbatimin e kontrates.dhe per kete provuar kete kusht duhet te kete një punësim mesatar per periudhen , Gusht i vitit 2020 , deri ne Janar 2021 i te pakten 280 (dyqind e tetedhjetë) personave duke përfshirë stafin e përhershëm te provuar si me poshte ;

- Kjo pike (2.3.4 ), provohet duket paraqitur nga ana e OE , vertetim te leshuar nga Dega e Tatimeve te Rrethit ose nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqerore te rrethit perkates dhe
- Listepagesat per periudhen e mesiperme (E-sig 025) sipas formatit elektronik ne perputhje me VKM nr 922 date 29.12.2014’’Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike’’

2.3.5 Operatori ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierike për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licensen e shoqërisë përkatëse si më poshtë:

- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi.
- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi (profili infrastrukture).
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik.
- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik.
- 1 (nje) Inxhinier gjeodet /Topograf/Markshajder/Gjeomatik .
- 1 (nje) Inxhinier elektrik.
- 1 (një) Inxhinier mjedisi.

*Per stafin e mesiperme inxhinierik duhet te paraqiten kontrate pune (e vlefshme) dhe diplomë përkatëse si dhe te figurojne ne Listpagesat e shoqerise për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.*

Operatori ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierike për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt krahas stafit të percaktuar tek pika 2.3.4 duhet të ketë staf mbështetës inxhinierik si me poshte:

- 1 (nje) Arkitekt
- 1 (nje) inxhinier gjeodet
- 1 (nje) inxhinier mekanik
- 1 (nje) inxhinier ndertimit profil strukturist
- 1 (nje) inxhinier hidroteknik

*Per stafin e mesiperm inxhinierik duhet te paraqiten kontrate pune (e vlefshme) dhe diplomë përkatëse si dhe te figurojne ne Listpagesat e shoqerise për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.*

2.3.6 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar si:

a) (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.

b) 1 (një) punonjës të disponojë çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.

c) 1 (një) punonjës të disponojë çertifikatë si "Koordinator për realizimin e punimeve në siguri dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" e cila të jetë e lëshuar nga shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.

2.3.7 Krahas stafit të mesiperm të ketë të punësuar staf mbështetës si me poshte:

- |                    |             |   |
|--------------------|-------------|---|
| - Teknik Ndertimi  | 3 (tre)     | Certifikate trajnimi ose Deshmi Profesionale; |
| - Elektricist      | 2 (dy)      | Certifikate trajnimi ose Deshmi Profesionale; |
| - Hidraulik        | 3 (tre)     | Certifikate trajnimi ose Deshmi Profesionale; |
| - Karpentiere      | 10(dhjete)  | Certifikate trajnimi ose Deshmi Profesionale; |
| - Mekanik          | 2 (dy)      | Certifikate trajnimi ose Deshmi Profesionale  |
| - Saldator         | 2 (dy)      | Certifikate trajnimi ose Deshmi Profesionale  |
| - Murator          | 10 (dhjete) | Certifikate trajnimi ose Deshmi Profesionale  |
| - Pllakashtrues    | 6 (gjashte) | Certifikate trajnimi ose Deshmi Profesionale  |
| - Bojaxhi          | 3 (tre)     | Certifikate trajnimi ose Deshmi Profesionale  |
| - Punetor ndertimi | 10 (dhjete) | Certifikate trajnimi ose Deshmi Profesionale  |

Operatori ekonomik duhet të paraqes për stafin e mesiperm: kontratat individuale të punës, Certifikate trajnimi ose Deshmi Profesionale për çdo kategori të mesipërme dhe stafi i mesiperm të figurojë në listëpagesat e shoqërisë të paktën 3 (tre) muajt e fundit

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 5 (pesë) punonjës drejtues të makinerive të renda, për të cilët duhet të paraqitet: kontrata e punës e vlefshme, Deshmi e Aftesise

Profesionale (e vlefshme) lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në list-pagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit:

- Eskavatorist 7
- Automakiniste 5
- Buldozerist 2
- Shofera 10 (dhjete)

**2.3.8** Operatori ekonomik te kete te punesuar nje ekspert zjarrefikes te shoqeruar me: -kontrate pune te vlefshme, certifikaten e zjarrefiksi, si dhe te jete ne listepagesa per te paktën 3 (tre) muajt e fundit.

**2.3.9** Operatori ekonomik të jetë i pajisur me licence nga Qendra Kombetare e licensimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte” dhe (QKL) Kodi III.2.B Grumbullim,transportim, ruajtje, riciklim, asgjesim i mbetjeve jo te rrezikshme.

**2.3.10** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, konkretisht:

- a) ISO 9001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit te Cilesise); (ose ekuivalente) *(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën OHSAS/ISO).*
- b) ISO 14001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor); (ose ekuivalente) *(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën OHSAS/ISO).*
- c) OHSAS ISO 45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurise ne Pune) (ose ekuivalente) *(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën OHSAS/ISO).*
- d) ISO 50001(Sistemi i Menaxhimit te Energjise) (ose ekuivalente) *(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën OHSAS/ISO).*
- e) BS PAS 99:2012 (Sistemi i Menaxhimit te Energjise) (ose ekuivalente) *(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën OHSAS/ISO).*

Te gjitha certifikata e mesiperme duhet te jene te lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizmat ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.11-Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

- Kandidati/ofertuesi duhet te disponoje makinerite dhe mjetet si vijon ne pronesi ose me qera.

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
2	Eskavator me goma	Copë	1	Në pronësi ose me qera

3	Minieskavator me zinxhir gome	Copë	2	Në pronësi ose me qera
4	Kamiona vetshkarkues min 15 ton	Copë	5	Në pronësi ose me qera
5	Kamiona vetshkarkues min 25 ton	Copë	5	Në pronësi ose me qera
	Rimorkiator	cope	2	Ne pronesi ose me qera
	Koke terheqese e Rimorkiatorit		2	Në pronësi ose me qera
6	Kamioncine me kapacitet mbajtes 1-3 ton	Cope	3	Në pronësi ose me qera
7	Mini fadrome	Copë	1	Në pronësi ose me qera
8	Gjenerator deri ne 75 kwa	Copë	2	Në pronësi ose me qera
9	Betoniere 500 litra	Copë	6	Në pronësi ose me qera
10	Autobetoniere	Copë	10	Në pronësi ose me qera
11	Autopompe	Copë	2	Në pronësi ose me qera
12	Auto vinc		1	Në pronësi ose me qera
14	Armature druri	m2	1000	Në pronësi ose me qera
15	Autobot uji		1	Në pronësi ose me qera
16	Greider		1	Në pronësi ose me qera
17	Rrul cilinder-gome mbi 10-14 ton		2	Në pronësi ose me qera
19	Nyje inerte	Copë	1	Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi
20	Nyje betoni	Copë	1	Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi
21	Impajnt betoni mobil me kapacitet mbi 100 m3 ne ore		1	Në pronësi ose me qera
22	Gjysem rimorkio Cisterne cimentoje		1	Në pronësi ose me qera
	Koke terheqese e gjysem rimorkios		1	Në pronësi ose me qera
23	Gure thyese mobile		1	Në pronësi ose me qera
25	Fikese zjarri		5	Në pronësi ose me qera
26	Helikopter per nivelime shtresash		1	Në pronësi ose me qera
27	Kompresor me ajer		2	Në pronësi ose me qera
28	Pompe suvatimi		3	Në pronësi ose me qera
29	Elektro-argano		2	Në pronësi ose me qera
30	Moto saldatrice		2	Në pronësi ose me qera
31	Saldatrice		2	Në pronësi ose me qera
32	Vibrator thellesie		8	Në pronësi ose me qera
33	Cekic hidraulik		1	Në pronësi ose me qera
34	Skela	m2	700	Në pronësi ose me qera

Të paraqiten pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 50 (pesedhjetë) copë
- Jelekë minimumi 50 (pesedhjetë) copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 10 (dhjetë) copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 10 (dhjetë) copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 15 (pesëmbëdhjetë) copë

- Karroca dore minimumi 5 (pese) copë
  - a. Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojnë pronesinë e mjetit: -leja e qarkullimit; -çertifikaten e kontrollit teknik; - siguracionin; - taksat vjetore- leja e transportit, foto te mjeteve ku te dallohet qarte targa;
  - b. Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: krahas dokumentave te percaktuara ne piken a me siper edhe kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi dhe çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit per llogari te te treteve (e vlefshme).
  - c. Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimin, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerases e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhën e realizimit te punimeve deri ne perfundimin e plote te punimeve.
  - d. Për Nyjen e Inerteve ne rast se eshte ne pronesi duhet te paraqiten dokumente qe vertetojnë pronesinë e saj, (Leje shfrytezimi per karrieren, leje mjedisore per karrieren, leje mjedisore per impjantin) dhe dokumentacion qe verteton pronesinë.  
Ne rast se Nyja e Inerteve eshte me qera ose kontrate furnizimi duhet te paraqitet kontrata e qerases/furnizimi e shoqeruar me dokumente qe vertetojnë pronesinë e saj, (Leje shfrytezimi per karrieren, leje mjedisore per karrieren, leje mjedisore per impjantin).
  - e. Për nyjen e betonit ne pronesi duhet te paraqiten kontrata e blerjes apo zhdoganimit ose fatura tatimore perkatese, leja mjedisore leshuar nga QKL fotot, vendodhja e impjantit, karta teknologjike e prodhimit te betonit leshuar nga institucinet perkatese. Nese eshte marre me qira krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata noteriale e qirase me kohëzgjatje deri në përfundim të realizimit të kërkesave të kësaj procedure. Ne kete rast duhet te paraqese kontraten e qirase dhe dokumentacionin qe verteton ekzistencen dhe pronesinë e impiantit.
  - f. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruar sipas shtojcës 13, nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera nga Autoriteti Kontraktor. *(Mos plotesimi i ketij kriteri perben kusht per skualifikim).*
  - g. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në shtojcën 13, në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor. *(Mos plotesimi i ketij kriteri perben kusht per skualifikim).*
  - h. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve dhe pajisjeve sipas shtojcës 13, ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor (KVO). *(Mos plotesimi i ketij kriteri perben kusht per skualifikim).*
- *Autoriteti përgjegjës mund të përcaktojë kriteret kualifikimi sipas natyrës dhe objektit të prokurimit duke pasur respektuar kuadrin regullator të rindërtimit dhe LPP.*
  - *Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.*



**Shtojca 16**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti përgjegjës)*

**PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE**

Përshkrimi i të dhënave teknike të punëve objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

**KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektit etj:

Specifikimet Teknike të Materialeve:

Grafiku i Punimeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

**Shtojca 17**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti përgjegjës)*

**PREVENTIVAT E PUNIMEVE****Shtojca 18**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës* ]

**GRAFIKU I ZBATIMIT TË PUNIMEVE**

Shtojca 19

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>5</sup>

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit përgjegjës]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Aktin Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u skualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

---

---

---

---

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Përgjegjës ka shkelur Aktin Normativ gjatë procedurës së prokurimit publik për rindërtimin, atëherë keni të drejtë të ankoheni siç parashikohet në nenin 42 të Aktit Normativ nr.9/2019.

---

<sup>5</sup> Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Me respekt  
< Emri >

Shtojca 20

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës ]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data\_\_\_\_\_]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

\* \* \*

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar:

1. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

2. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Etj.

\* \* \*

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në fazën tjetër të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë numri i NUIS-it  
Vlera \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë numri i NUIS-it  
Vlera \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
 Emri i plotë i shoqërisë \_\_\_\_\_ numri i NUIS-it \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_  
 Emri i plotë i shoqërisë \_\_\_\_\_ numri i NUIS-it \_\_\_\_\_

Etj.  
 Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri, Nipti dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur nga ana juaj dhe e vlerësuar me \_\_\_\_\_ pikë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit përgjegjës dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra].

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_  
 (nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit përgjegjës]

Shtojca 21

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË  
 MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_  
 2. \_\_\_\_\_  
 3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit: \_\_\_\_\_

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  oferta ekonomikisht më e favorshme  çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm për lidhjen e marrëveshjes kuadër:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_ / Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_ / Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit përgjegjës dhe referenca e kontaktit], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_  
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit përgjegjës]

Shtojca 22

### KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS

Punët

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Përgjegjës dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Përgjegjës se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Përgjegjës lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontrates. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, “data e fillimit “do te jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kon Përgjegjës traktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për autoritetin përgjgjës.
- 2.15 “Autoritet Përgjegjës” do të thotë Autoriteti Përgjegjës qe është pjese e kesaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo qe përdoret ka kuptim të njëjtë me ate te perkufizuar ne ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.

2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Përgjegjës i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.

3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikët e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

4.1 Autoriteti Përgjegjës mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupsionit. Veprimet e korrupsionit përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.

4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.

4.3 Kontraktori duhet të lejojë autoritetin përgjegjës të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Përgjegjës.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Përgjegjës duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Përgjegjës deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtonte ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

